



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA TROPOJE  
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Bajram Curri, më 13.09.2019

**Lënda:** Dërgim i Dokumentit të Programit Buxhetor Afatmesëm i rishikuar

**Drejtuar:** Ministrise së Financave

-Drejtore së Financave Vendore

Bashkia Tropoje ka miratuar kalendarin e buxhetit për PBA-në 2020-2022 me Vendimin nr .187 dt 19.12.2018.Ka realizuar të gjitha fazat e parashikuara në kalendarin e buxhetit.,deri në këtë periudhë.Ka reflektuar rekomandimet e dhëna në shkresen nr.11597 date 18.06.2019 të Minsistrise së Financave “*Dergohen mendimet per PBA-ne 2020-2022*..Janë plotësuar të gjitha të dhënat që disponohen.

Në hartimin e dokumentit perfundimtar të PBA-së per periudhen 2020-2022 i cili do te miratohet brenda muajit nentor ,do te pershkruhen qartë per çdo program,qëllimet,objektivat dhe produktet perfundimtare që synohen të arrihen.Bashkia ka publikuar në Ëeb-in e Bashkise PBA- në ,2020-2022.

Në baze të kalendarit të buxhetit,pika 10 e kalendarit,referuar nenit 10 te Ligjit 68/2017” *Për financat e qeverisjes vendore*”,Keshilli i qeverisjes vendore duhej të miratonte ,projekt buxhetin afatmesem brenda dates 20 Korrik 2019.

Për kete qellim ,nga Ministria e Financave është dërguar Udhezimi , nr 20 date 10.07.2019,ku citonte detyrimin ligjor ,për miratimin në Këshill të ketij dokumenti të rendesishem për financat e Bashkise.

Me Vendimin nr .72 date 12.07.2019,”*Për miratimin e tavaneve përfundimtare të projekt Buxhetit afatmesëm 2020-2022” janë miratuar tavanet e PBA-se 2020-2022”*.

Me shkresën nr.2/50 date 19.07.2019 ”*Verifikim i ligjshmerise se akteve*”të Prefektit të Qarkut Kukes ky Vendim nuk është miratuar nga Institucioni i Prefektit.,me argument citimin e Ligjit 139 /2015”*Per veteqeversijen vendore*” neni 53 ,pika 6.,ku citohet “*Ne periudhen nga data e*

*zgjedhjeve dhe deri ne konstutuimin e Keshillit te ri ,keshilli i meparshem,ushtron kopetenca te kufizuara,dhe merr vendime vetem ne raste te situatave emergjente”*

Gjykojmë që kjo është një pikë që duhet të sqarohet,pasi mendojme që të qartsohet nga MF,pasi mund të ndodhe dhe here të tjera që ne vite zgjedhore ,tëndodhin këto perplasje mes dispozitave ligjore,**pasi dhe afati që nga data e zgjedhjeve deri ne konstituimin e këshillave ,ngritjen e komisioneve përkatese është një hark kohor, që zgjat jo më pak se dy muaj.**

Bashkia Tropoje ,ka riparaqitur projekt-vendimin për miratimin e tavaneve të PBA-së 2020-2022 ,në mbledhjen e datës 31.08.2019,

Janë miratuar tavanet e projekt buxhetit me Vendimin nr.10 date 31.08.2019,”*Mbi miratimin e tavaneve te Projekt Buxhetit Afatmesem 2020-2022 te Bashkise Tropoje*”,i cili është miratuar nga Prefekti i Qarkut Kukës.

Ne baze të kalendarit,Bashkia ka hartuar grafikun e dëgjësive publike që duhet të përfundojnë brenda datës 30.09.2019.

Me kaq e konsiderojme të ezauruar,piken “16” të kalendarit me pershkrim”*Bashkia Tropoje ,dërgon në Ministrinë e Financave ,Dokumentin e programit Buxhetor Afatmesëm të rishikuar,të miratuar nga Keshilli i Bashkise,së bashku me një informacion mbi zabtimin e rekomandimeve të dhena nga Ministria e Financave gjatë fazës së parë të hartimit tëPBA-së”*

Bashkëlidhur,

1-Relacionin për PBA-në 2020-2022.

2.Vendimin nr.10 datë 31.8.2019 Për miratimin e tavaneve te programeve buxhetore.

3.Konfirmimi i prefektures Kukës.

K R Y E T A R I

Rexhe Byberi